



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 23 Qershor 2021 Nr: 413

V E N D I M

**PËR SHPËRNDARJEN E MANDATEVE MIDIS SUBJEKTEVE ZGJEDHORE DHE
PËRCAKTIMIN E KANDIDATËVE FITUES NË ZONËN ZGJEDHORE QARKU KORÇË PËR
ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË TË DATËS 25.04.2021**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “i”, e 2, 162 dhe 163, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N:

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miraton shpërndarjen e mandateve në zgjedhjet për Kuvendin dhe për këshillat vendorë, si dhe jep mandatet për çdo deputet, bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “i”, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 346, datë 4.05.2021 ka miratuar Tabelën Përmbledhëse të rezultatit për subjektet zgjedhore për zonën zgjedhore Qarku Korçë. Kundër këtij vendimi, brenda afateve ligjore u paraqitën kërkesa ankimore ku midis të tjerash u kundërshtua dhe vendimi nr. 346, datë 4.05.2021. Në përfundim të shqyrtimit të ankimeve Kolegji Zgjedhor vendosi lënien në fuqi të vendimit të Komisionerit.

Në përfundim të shqyrtimit të ankimit, Komisioneri në mbështetje të nenit 162, pika 1, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, përllogarit shpërndarjen e mandateve për Kuvendin.

Në bazë të nenit 162, pika 1, përjashtohen nga shpërndarja e mandateve subjektet zgjedhore që kanë marrë më pak se 1 për qind të votave të vlefshme në shkallë vendi. Subjektet zgjedhore që plotësojnë kushtin për t’u përfshirë në përllogaritjen e shpërndarjes së mandateve janë:

Nr.	Subjekti zgjedhor	Vota	Përqindje
1.	Partia Socialiste e Shqipërisë	768.134	48,67%
2.	Koalicioni “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim”	622.187	39,42%
3.	Lëvizja Socialiste për Integrim	107.538	6,81%
4.	Partia Socialdemokrate	35.475	2,25%



Rezultati për Qarkun Korçë për subjektet zgjedhore, sipas vendimit nr. 346, datë 4.05.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, është si më poshtë:

Nr.	Subjekti zgjedhor	Vota	Përqindje
1	Partia Socialdemokrate	1.267	1,02%
2	Partia Balli Kombëtar	138	0,11%
3	Partia Lëvizja Demokratike Shqiptare	596	0,48%
4	Partia Bindja Demokratike	772	0,62%
5	Koalicioni “Aleanca Bashkimi Popullor Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët”	91	0,07%
6	Lëvizja Socialiste për Integrim	8.493	6,86%
7	Partia Nisma Thurje	721	0,58%
8	Partia Lëvizja e Re	344	0,28%
9	Koalicioni “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim”	50.479	40,77%
10	Partia Aleanca Demokracia e Re	120	0,10%
11	Partia Lëvizja Për Ndryshim	248	0,20%
12	Partia Socialiste e Shqipërisë	60.543	48,90%
Totali i votave të vlefshme		123.812	100%

Subjektet zgjedhore që plotësojnë kushtin për t’u përfshirë në përllogaritjen e shpërndarjes së mandateve kanë fituar vota si më poshtë:

Nr.	Subjekti zgjedhor	Vota
1	Partia Socialiste e Shqipërisë	60.543
2	Koalicioni “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim”	50.479
3	Lëvizja Socialiste për Integrim	8.493
4	Partia Socialdemokrate	1.267

Në bazë të nenit 162, pika 2, numri i votave të vlefshme në nivel zone zgjedhore të secilit subjekt pjesëtohet në mënyrë të vazhdueshme me numra natyrorë të njëpasnjëshëm, të quajtur pjesëtues, duke filluar me numrin 1 dhe duke përfunduar me numrin natyror 11 (njëmbëdhjetë) që i korrespondon numrit të mandateve që shpërndahen në zonën zgjedhore qarku Korçë në bazë të vendimit të Komisionit Rregullator nr. 7, datë 11.12.2020.

Subjekti zgjedhor/ pjesëtuesit	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Herësit
PS	60.543	30.272	20.181	15.136	12.109	10.091	8.649	7.568	6.727	
PD-AN	50.479	25.240	16.826	12.620	10.096	8.413	7.211	6.310	5.609	
LSI	8.493	4.247	2.831	2.123	1.699	1.416	1.213	1.062	944	
PSD	1.267	634	422	317	253	211	181	158	141	

Sipas nenit 162, pika 4, herësit e përfutur nga çdo pjesëtim, renditen nga herësi më i madh tek ai më i vogël, duke renditur përkrah tyre subjektin, të cilit i përket herësi përkatës. Renditja vazhdon derisa të renditen aq herës sa është numri i mandateve që shpërndahen në zonën zgjedhore qarku Korçë, pra 11. Nga kjo renditje marrim rezultatin si më poshtë:



Nr.	Subjekti zgjedhor	Herësit
1	PS	60.543
2	PD-AN	50.479
3	PS	30.272
4	PD-AN	25.240
5	PS	20.181
6	PD-AN	16.826
7	PS	15.136
8	PD-AN	12.620
9	PS	12.109
10	PD-AN	10.096
11	PS	10.091

Në bazë të nenit 162, pika 5, një subjekt zgjedhor përfiton një numër mandatesh të barabartë me numrin e herësve të përfshirë në listën e përcaktuar më sipër.

Sipas nenit 163, pika 1, të Kodit Zgjedhor, menjëherë pas përfundimit të llogaritjes së rezultatit si më sipër, KQZ-ja përllogarit shpërndarjen e mandateve për kandidatët fitues për secilin subjekt.

Shpërndarja e mandateve fillon me rend zbritës, në bazë të renditjes së tyre në listën shumëmemërore, duke filluar nga numri rendor një, si dhe numrit të votës parapëlqyese të secilit kandidat.

Rezultati për kandidatët për deputetë për zonën zgjedhore Qarku Korçë, për subjektin zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, sipas vendimit nr. 346, datë 4.05.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, është si më poshtë:

Nr.	Kandidatët e subjektit PS			Gjinia	Vota parapëlqyese
	Emër	Atësi	Mbiemër		
1	Enslemvera	Vehbi	Zake	F	3.068
2	Blerina	Guri	Gjylameti	F	5.363
3	Ilirian	Anesti	Pendavinji	M	6.233
4	Ilir	Osman	Topi	M	5.043
5	Olta	Anxhelo	Xhaçka	F	4.783
6	Niko	Aleks	Peleshi	M	11.475
7	Edlira	Përparim	Bode	F	1.196
8	Bledi	Dhimitraq	Çomo	M	5.787
9	Besa	Gezim	Spaho	F	688
10	Dhora	Thanas	Shkambi	F	1.258
11	Arian	Nasibi	Jaupllari	M	5.157
12	Vasil	Kërstin	Sterjovski	M	1.331
Gjithsej					51.382

Sipas nenit 163, pika 3, të Kodit Zgjedhor, në fillim përfitojnë mandat kandidatët që kanë marrë një numër votash parapëlqyese më të madh se herësi që del nga pjesëtimi i numrit të votave të subjektit me numrin e mandateve të fituara nga subjekti në zonën zgjedhore. Në çdo rast, herësi nuk mund të jetë më shumë se 10 mijë vota.



Për subjektin zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë herësi është 10.090, pra merret 10 mijë. Kandidatë me numrin më të lartë të votave parapëlqyese se herësi dhe që janë të renditur poshtë numrit 6 (gjashtë) të mandateve të fituara nga ky subjekt, nuk ka dhe në bazë të nenit 163, pika 1 dhe 6, shpërndarja e mandateve vijon sipas renditjes në listë.

Rezultati për kandidatët për deputetë për zonën zgjedhore Qarku Korçë, për subjektin zgjedhor Koalicioni “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim”, sipas vendimit nr. 346, datë 4.05.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, është si më poshtë:

Nr.	Kandidatët e subjektit PD-AN			Gjinia	Vota parapëlqyese
	Emër	Atësi	Mbiemër		
1	Edmond	Shyqyri	Spaho	M	5.921
2	Sorina	Vangjush	Koti	F	1.618
3	Ervin	Bujar	Salianji	M	9.420
4	Bledjon	Tomor	Nallbati	M	7.412
5	Seladin	Fuat	Jakupllari	M	7.342
6	Marjeta	Bardhyl	Halili	F	2.320
7	Andrea	Nesti	Mano	M	5.465
8	Alfred	Perparim	Gega	M	2.829
9	Soela	Arjan	Myrtollari	F	1.124
10	Erion	Skender	Haruni	M	266
11	Andrea	Kostandin	Simaku	M	254
12	Anila	Namik	Hysenbegasi	F	412
Gjithsej					44.383

Për subjektin zgjedhor Koalicioni “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim” herësi është 10.096, pra merret 10 mijë. Kandidatë me numrin më të lartë të votave parapëlqyese se herësi dhe që janë të renditur poshtë numrit 5 (pesë) të mandateve të fituara nga ky subjekt, nuk ka dhe në bazë të nenit 163, pika 1 dhe 6, shpërndarja e mandateve vijon sipas renditjes në listë.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “i”, e 2, 162 dhe 163, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

V E N D O S:

1. Të shpërndaj mandatet për subjektet zgjedhore në zonën zgjedhore Qarku Korçë, si më poshtë:
 - a) Partia Socialiste e Shqipërisë 6 mandate
 - b) Koalicioni “Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim” 5 mandate

2. Të shpall kandidatët fitues për deputetë për Qarkun Korçë për subjektin zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, si më poshtë:

1	Enslemvera	Vehbi	Zake
2	Blerina	Guri	Gjylameti
3	Ilirian	Anesti	Pendavinji
4	Ilir	Osman	Topi
5	Olta	Anxhelo	Xhaçka
6	Niko	Aleks	Peleshi

3. Të shpall kandidatët fitues për deputetë për Qarkun Korçë për subjektin zgjedhor Koalicioni “Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim”, si më poshtë:

1	Edmond	Shyqyri	Spaho
2	Sorina	Vangjush	Koti
3	Ervin	Bujar	Salianji
4	Bledjon	Tomor	Nallbati
5	Seladin	Fuat	Jakupllari

4. Të miratoj rirenditjen e kandidatëve në listën shumemërore të subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë, të cilët nuk kanë përfitur mandat, në bazë të numrit të votave parapëlqyese duke filluar nga numri më i lartë i votave, si më poshtë:

Nr.	Emër	Atësi	Mbiemër	Gjinia	Vota parapëlqyese
7	Bledi	Dhimitraq	Çomo	M	5.787
8	Arian	Nasibi	Jaupllari	M	5.157
9	Vasil	Kërstin	Sterjovski	M	1.331
10	Dhora	Thanas	Shkembali	F	1.258
11	Edlira	Përparim	Bode	F	1.196
12	Besa	Gezim	Spaho	F	688

5. Të miratoj rirenditjen e kandidatëve në listën shumemërore të subjektit zgjedhor koalicionin “Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim” të cilët nuk kanë përfitur mandat, në bazë të numrit të votave parapëlqyese duke filluar nga numri më i lartë i votave, si më poshtë:

Nr.	Emër	Atësi	Mbiemër	Gjinia	Vota parapëlqyese
6	Andrea	Nesti	Mano	M	5.465
7	Alfred	Perparim	Gega	M	2.829
8	Marjeta	Bardhyl	Halili	F	2.320
9	Soela	Arjan	Myrtollari	F	1.124
10	Anila	Namik	Hysenbegasi	F	412
11	Erion	Skender	Haruni	M	266
12	Andrea	Kostandin	Simaku	M	254

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
Ilirjan CELIBASHI

